



Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar më datë 13.06.2023	
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-336

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAČ / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / SAOBNIĆ PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET	
Njesia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)	
Nr./Br./No 786	171
Data/Datum/Date 12.06.2023	2023
RAHOVEC / ORAHOVAČ	



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"UKSHIN HOTI" PRIZREN**

**KOMUNA E RAHOVECIT
RAHOVEC MUNICIPALITY**

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" PRIZREN
DHE
KOMUNËS SË RAHOVECIT**

Neni 1

Marrëveshja e Bashkëpunimit (në tekstin e mëtejme Marrëveshje) lidhet mes Komunës së Rahovecit (në tekstin e mëtejme Komuna), e përfaqësuar nga kryetari Smajl Latifi dhe Universitetit "Ukshin HOTI" Prizren (në tekstin e mëtejme Universiteti, përfaqësuar nga Rektori Prof. Asoc. Dr. Mentor Alishani).

Neni 2

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është të përcaktojë kushtet e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve për interesin reciprok.

Neni 3

Komuna dhe Universiteti pajtohen që, për interesa të përbashkëta, të asistojnë, të promovojnë, të përkrahin dhe të ngrenë nivelin e bashkëpunimit reciprok në mes të tyre, në funksion të zhvillimit të përgjithshëm edukativ, social dhe ekonomik, dhe ngritjen profesionale të studentëve.

Neni 4

Komuna dhe Universiteti, së bashku, do të kontribuojnë në drejtim të zhvillimit, të përkrahjes dhe të promovimit të sektorit edukativ dhe profesional, ofrimin e shërbimeve përkatëse për këtë universitet, gjenerimin e punësimit dhe zvogëlimin e papunësisë. Në këtë aspekt, Universiteti do t'i ofrojë ndihmë shkencore-profesionale Komunës me shërbimet e veta.

Neni 5

Komuna dhe Universiteti pajtohen që të bashkëpunojnë për hartimin dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me përmirësimin e ambientit ekonomik dhe social.

Neni 6

Komuna do të pranojnë në bazë të mundësive një numër të studentëve të Universitetit për të bërë praktikën profesionale nëpër zyrat e Komunës dhe të institucioneve vartëse.

Neni 7

Komuna do të angazhohet që, në bazë të mundësive, të ofrojë bursa për studentët e Universitetit, atyre me gjendje të rënduar ekonomike, përfshirë edhe familjet e kategorive të dala nga lufta e fundit në Kosovë.

Neni 8

Komuna dhe Universiteti pajtohen që, për nevoja të tyre, të shkëmbejnë ekspertë dhe përvojat e tyre në fushat e caktuara, që kanë kapacitete dy palët.

Neni 9

Komuna dhe Universiteti pajtohen që të angazhohet një përfaqësues i Komunës në Bordin Këshillues Industrial të Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit.

Neni 10

Komuna dhe Universiteti pajtohen për shfrytëzimin e institucioneve dhe të hapësirave komunale për studentët, stafin akademik dhe administrativ, si: Biblioteka komunale, Qendra sportive, fusha sportive, institucione kulturore - komunale, etj.

Neni 11

Komuna do të mbështesë Universitetin, në kuadër të mundësive, në Organizimin e Shkollës Verore Ndërkombëtare.

Neni 12

Komuna dhe Universiteti pajtohen që të bashkëpunojnë gjatë procesit të hartimit të planeve dhe të dokumenteve strategjike të të dyja palëve.

Neni 13

Marrëveshja ka afat vlefshmërie për periudhë 5 (pesë) - vjeçare të bashkëpunimit, me mundësi vazhdimi dhe plotësim - ndryshimi me pajtimin e të dyja palëve.

Neni 14

Marrëveshja e bashkëpunimit është e nënshkruar në dy kopje në gjuhën shqipe.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Rektori:

Prof. Asoc. Dr. Mentor Alishani



Kryetari i Komunës:

z. Smajl Latifi

